

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS** në shkallë të parë përmes Gjyqtares së EULEX-it ROSITZA BUZOVA në rastin civil të paditësit FK nga Prishtina, i përfaqësuar nga avokati NH nga Prishtina, kundër të paditurit PS, ish nga Prishtina, aktualisht me banim në Novi Sad, Republika e Serbisë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, anulimin e vendimit për ndarjen e banesës dhe kontratën e blerjes, në përputhje me nenin 142, paragrafi 5, nenin 387, paragrafi 1, pika ë), neni 391, pikat d) dhe g) të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (tutje "LPK"), më 26 shkurt 2013 nxjerr në vijim

## **AKTVENDIM**

Padia paraqitur nga paditësi FK nga Prishtina, i përfaqësuar nga avokati NH nga Prishtina, kundër të paditurit PS, dikur nga Prishtina, tani me banim në Novi Sad, Republika e Serbisë, për vërtetimin e pronësisë lidhur me banesën në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L-1, kati 9, nr.35, anulimin e vendimit për ndarjen e saj dhe kontratën për blerjen e saj nga i padituri **HEDHET POSHTË** si e **PALEJUESHME** në pajtim me nenin 102, paragrafi 3, fjalia e parë LPK, neni 78, paragrafi 4 *in fine* LPK, neni 253, paragrafi 5 LPK në lidhje me Seksionin 6.6 të Urdhëresës Administrative № 2008/2002 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe neni 166, paragrafi 2 LPK në lidhje me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore.

## **ARSYETIM**

### **I. HISTORIKU PROCEDURAL**

1. Më 20 dhjetor 2006, FK e paraqiti në Gjykatën Komunale të Prishtinës një padi kundër PSIT, duke pretenduar se si një punonjës i OPPB "ELEKTROEKONOMIA E KOSOVËS", tani "KORPORATA ENERGJE-TIKE E KOSOVËS", MS "Kosova" Bardhë me Vendimin № 2092, datë 18 shtator 1989 i ishte ndarë një banesë në Prishtinë, "Dardania" SU- 9, L-1, kati IX, nr.35. Ai nuk ka mundur të hyjë në posedim të tij, pasi që banesa në atë kohë ishte ende në ndërtim e sipër. Ndërkohë, me Vendimin № 3432, datë 16 nëntor 1990, Organi i Përkohshëm i ndërmarrjes ia ndërpreu atij marrëdhënien e punës. Ai paraqiti ankesë ndaj këtij shkarkimi si diskriminues dhe i paligjshëm para Gjykatës së Punës së Bashkuar në Prishtinë. Në vitin 1993 banesa iu nda një punonjësi serb, PSIT, dhe pastaj ajo iu shit atij. Ky vendim i ndarjes ishte i paligjshëm, në kundërshtim me aktet normative të ndërmarrjes. Kështu, kontrata e blerjes në bazë të saj ishte gjithashtu e pabazuar ligjërisht. Petiti është që gjykata ta vërtetojë se paditësi është pronar i banesës, të anulojë vendimin për ndarjen e saj dhe kontratën e blerjes së të paditurit.

2. Padia ishte regjistruar për gjykim në C.nr.2724/2006 të Gjykatës Komunale të Prishtinës. Asnjë veprim procedural nuk ishte marrë në lidhje me rastin në 6 vitet e ardhshme, *inter alia*, kërkesa nuk ishte korigjuar, plotësuar apo ndryshuar.

## II. KOMPETENCA E GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS

3. Ky rast civil i shkallës së parë u zgjodh në bazë të nenit 5, paragrafi 1, pika c) të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat") (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008) dhe neni 3, paragrafi 1 i Udhëzimeve për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve të EULEX-it në rastet civile, të miratuara nga Kuvendi i 21-të i Gjyqtarëve të EULEX-it më 11 dhjetor 2012 ("Udhëzimet") përmes aktvendimit ref.nr. ED/EJU/MJU/0016/cd/12, i lëshuar më 1 nëntor 2012 nga i deleguari i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, sipas aktvendimit ref.nr.2012.OPEJ.0064 - 0001 i datës 30 tetor 2012. Pas kryerjes së procedurës së marrjes përsipër të rastit, ashtu siç parashihet me nenin 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat dhe neni 3, paragrafi 6, paragrafi 6 i Udhëzimeve me anë të aktvendimit ref.nr.2012.OPEJ.0142-0001 i Nënkyetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 26 dhjetor 2012 në pajtim me nenin 5, paragrafi 7, fjalia e dytë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat dhe nenit 3, paragrafi 8 i Udhëzimeve, rasti i është caktuar Gjyqtarit të EULEX-it për çështje civile në Njësinë Mobile në nivel të Gjykatës Themelore të përcaktuar në përputhje me nenin 4, paragrafi 2, fjalia e parë dhe paragrafi 4 i Udhëzimeve.

4. Në pajtim me dispozitën kalimtare të nenit 39, paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/11), ky rast civil i shkallës së parë i Gjykatës Komunale të Prishtinës, si i papërfunduar më 1 janar 2013, pa kësaj date është trajtuar si një rast i Gjykatës Themelore të Prishtinës.

## III. MANGËSITË FORMALE DHE PROCEDURALE TË PADISË

5. Pas ekzaminimit fillestar të padisë, janë identifikuar mangësitë e saj dhe me anë të Aktvendimit C.nr.2724/2006 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013, paditësi ishte i obliguar që t'i hiqte ato, siç parashikohet nga neni 390 LPK.

6. Pasi që padia nuk përmban *vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm* të paditësit në bazë të nenit 253, paragrafi 1, pika f) në lidhje me nenin 99, paragrafi 2, fjalia e dytë LPK, ky i fundit u udhëzua për ta plotësuar atë me të dhëna lidhur me vendbanimin e tij në pajtim me nenin 102, paragrafi 1 LPK.

7. Pasi që në kundërshtim me nenin 253, paragrafi 1, pika d) LPK *vlera e kontestit* nuk është specifikuar, paditësit i është kërkuar për ta përcaktuar atë në bazë të nenit 102, paragrafi 1 në lidhje me nenin 30, paragrafi 1 dhe nenit 32 LPK.

8. Padi të e bashkuara në këtë rast *nuk janë të individualizuara siç duhet sipas bazës së tyre faktike dhe juridike* sipas nenit 253, paragrafi 1, pika b) dhe e) në lidhje me nenin 99, paragrafi 2, fjalia e parë LPK deri në masën e kërkuar për gjykimin e tyre të duhur në bazë të nenit 2, paragrafi 1 LPK. *Në radhë të parë*, padia për vërtetimin e pronësisë mbi banesën e kontestuar është paraqitur pa ndonjë bazë të pretenduar për fitimin e saj nga FK të atyre të përcaktuara me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ № 6/1980) - nga vetë ligji, veprimi juridik, trashëgimia, vendimi i një autoriteti publik ose në një mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me ligj të veçantë. *Në radhë të dytë*, anulimi i vendimit për ndarjen e banesës së kontestuar në emër të PSIT kërkohet pa specifikimet e tij për nga numri, data dhe/ose lëshuesi, si dhe pa arsye të thirrura konkretisht për paligjshmëri. Asnjë dispozitë ligjore, çfarëdo qoftë ajo, nuk është përmendur në padi si e shkelur nga lëshimi i saj. *Në radhë të tretë*, kontrata e kundërshtuar nuk është përshkruar për nga palët, data, numri apo ndonjë kriter tjetër në padi, e cila gjithashtu nuk arrin të konkretizojë llojin e pavlefshmërisë së tij të supozuar, arsyet dhe ndihma e kërkuar ndaj saj. *Në radhë të katërt*, nuk është theksuar baza ligjore në asnjë prej padive të bashkuara në këtë rast nga paditësi, siç parashikohet nga neni 253, paragrafi 1, pika d) LPK, dhe asnjë dëshmi nuk është propozuar për t'i dëshmuar ato, edhe pse kërkohet nga neni 253, paragrafi 1, pika c) dhe neni 99, paragrafi 3 LPK. Për të siguruar këto kushte që mungojnë në padi, paditësi ishte udhëzuar të përcaktojë faktet që lidhen me fitimin e pronësisë mbi banesën e kontestuar, numri, data dhe lëshuesi i vendimit të kundërshtuar mbi ndarjen në emër të PSIT me arsyet e saj për paligjshmërinë, numrin, datën dhe palët e kontratës së kontestuar të blerjes me arsyet për pavlefshmërinë e saj, provat për të vërtetuar faktet e pretenduara, dhe për të precizuar kërkesëpadinë sipas mjeteve juridike, që kërkohen ndaj këtij vendimi dhe kësaj kontrate, që korrespondon me arsyet e thirrura për pavlefshmëri, sipas nenit 102, paragrafi 1 në lidhje me nenin 253, paragrafi 1, pikat a), b), c), d) dhe f) dhe neni 99, paragrafi 3 LPK.

9. Në kundërshtim me nenin 253, paragrafi 4 LPK padia është parashtruar pa ia bashkangjitur vërtetimin mbi taksat gjyqësore të paguara, edhe pse pagesa e tyre kërkohet në kohën e dorëzimit – Seksioni 5.1 i Urdhëresës Administrative № 2008/02 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, e ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin № 20/12, të datës 9 mars 2012 dhe № 37/12, të datës 23 mars 2012 (më tej "Urdhëresa Administrative KGJK № 2008/2002"). Kjo është arsyeja pse paditësit i ishte dhënë një njoftim, sipas nenit 253, paragrafi 5 LPK-së dhe Seksionit 6.5 të Urdhëresës Administrative KGJK № 2008/2002 për të paguar taksat gjyqësore në shumën e përcaktuar sipas tarifës në bazë të Seksionit 10 të kësaj Urdhërese Administrative KGJK № 2008/02 me paralajmërim për pasojat ligjore për mospagesë, të parashikuar nga neni 253, paragrafi 5 LPK dhe Seksioni 6.6 i Urdhëresës Administrative KGJK № 2008/2002.

10. Siç është vërejtur në Aktvendimin C.nr.2724/06 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika 7 e arsyetimit) në funksion të temës së rastit, nuk mund të vendoset me pjesëmarrjen e PSIT vetëm si një i paditur. Atij i mungon legjitimiteti pasiv në *kërkesën e dytë* për pavlefshmërinë e vendimit për ndarje të lëshuar në emër të tij, i cili duhet të vendoset në lidhje me subjektin publik – lëshuesin e saj, ose pasardhësi i tij aktual ligjor, që ka kapacitet të përgjithshëm procedural të jetë palë në rastin, sipas Nenit 73, paragrafi 1 LPK. Sa për *kërkesën e tretë* për anulimin e kontratës së blerjes, natyra e marrëdhënies juridike është e tillë sa që kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë në lidhje me *të dy palët kontraktuese* që e kanë lidhur atë. Kështu, shitësi i banesës kontestuese ose pasardhësi i tij ligjor duhet të jetë gjithashtu një i paditur në rast së bashku me PSIN si blerës i saj në çështjen gjyqësore të konsoliduar të përbashkët sipas nenit 269, paragrafi 1 LPK. Pasi që PSI nuk është i legjitimuar të jetë i padituri i vetëm në rast, për të përmirësuar këtë gabim, në përputhje me nenin 78, paragrafi 1 LPK me aktvendimin C.nr.2724/06 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika III) paditësi ishte udhëzuar që ta përmirësojë padinë, duke zgjeruar gamën e saj subjektive për lëshuesin e vendimit mbi ndarjen e kontestuar, dhe shitësin e kontratës së kontestuar të shitjes apo trashëgimtarët aktual ligjor të tyre, në mënyrë që procedura të vazhdojë me pjesëmarrjen e të gjitha këtyre palëve të paditura të cilat sipas kushteve të procesit gjyqësor të konsoliduar të përbashkët, sipas nenit 269, paragrafi 1 LPK, vetëm së bashku mund të jenë palë në mosmarrëveshje me këtë lëndë.

11. Padia është dorëzuar në gjykatë më 20 dhjetor 2006 me pjesën hyrëse, sipas të cilit FK është *i përfaqësuar* nga avokati NH nga Prishtina, Ulpiana, Dëshmorët e Kombit Sheshi, nr.72/A-2. Në këtë mënyrë nga vetë padia paditësi *personalisht* e ka autorizuar *në formë të shkruar* këtë avokat për ta përfaqësuar atë në këtë rast, në përputhje me nenin 97, paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91 dhe Gazeta Zyrtare e RSJ-s Nr. 27/92, 31/93, 24/94 dhe 12/98) (LPK 1977). Dhënë në përgjithësi, jo e specifikuar në detaje, ky autorizim është i zbatueshëm për të gjitha veprimet në procedurë, ashtu siç parashihen nga neni 95, paragrafi 1 LPK 1977. Vlefshmëria e tij dhe qëllimi nuk janë prekur nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri mbi Procedurën Kontestimore - neni i saj 533, paragrafi 1 thotë se procedura gjyqësore që ka mbetur pezull në shkallë të parë do të *vazhdojë* në përputhje me dispozitat e ligjit të ri, pa retroaktivitet për veprimet procedurale që ishin marrë para hyrjes së saj në fuqi. Përveç kësaj, neni 92, paragrafi 1 LPK, e cila tani përshkruan formën me shkrim për vlefshmërinë e autorizimit procedural, është identik me nenin 97, paragrafi 1 LPK 1977, ndërkohë që neni 90, paragrafi 2 LPK, që përcakton qëllimin e saj riprodhon nenin 95, paragrafi 1 LPK 1977. Për të gjitha këto arsye, kopje e Aktvendimit C.nr.2724/2006 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 15 janar 2013 iu dërgua paditësit, FKT më 21 janar 2013 nëpërmjet avokatit NH siç parashikohet nga neni 107, paragrafi 1, neni 110, paragrafi 1, dhe neni 118, paragrafi 1, fjalía e parë LPK.

Duke qenë i lëshuar në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare e gjykatës - neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, vendimi iu ishte dërguar me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, në përputhje me nenin 14 të Ligjit Nr.02/L-37 mbi Përdorimin e Gjuhëve. Pranimi i fletëdërgesës ishte nënshkruar në mënyrë të rregullt nga marrësi dhe dërguesi - neni 121, paragrafi 1, fjalia e parë LPK, gjersa data e saj - 21 janar 2013 shënohet nga marrësi në dorëshkrimin e tij - neni 121, paragrafi 1, fjalia e dytë LPK.

12. Pasi që Aktvendimi C.nr.2724/2006 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 15 janar 2013 ishte dërguar më 21 janar 2013, kjo datë është momenti fillestar i periudhës 3-ditore në bazë të nenit 102, paragrafi 1, LPK dhe neni 78, paragrafi 3 LPK për rregullimin e padisë të përcaktuar nga pika I - III e dispozitivit. Llogaritur në bazë të rregullit të nenit 126, paragrafi 2 LPK, nga dita e ardhshme e fillimit, kjo periudhë ka kaluar më 24 janar 2013 (e enjte) pa shtyerje sipas nenit 126, paragrafi 5 LPK deri në ditën e ardhshme të punës dhe/ose zgjatje sipas nenit 125, paragrafi 2 LPK e kërkuar nga pala. Nuk ka pasur parashtresa të paraqitura lidhur me rastin nga paditësi ose në emër të tij deri në skadimin e afatit në 24 janar 2013.

13. Më 20 shkurt 2013, lëndës iu dorëzua një Autorizim i veçantë, me datë 19 shkurt 2013, i nënshkruar nga FK në emër të avokatit NH nga Prishtina për përfaqësim në C.nr.2724/2006 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, me liri të përgjithshme veprimi, duke përfshirë të gjitha veprimet procedurale sipas nenit 90, paragrafi 2 dhe 3 LPK-së. Më 22 shkurt 2013, kopje e Aktvendimit C.nr.2724/06 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 me përkthimin e saj në gjuhën shqipe iu dërgua *përsëri* Avokat NHT, *pas këtij autorizimi të ri* të 19 shkurtit 2013, në përputhje me nenin 107, paragrafi 1 dhe nenin 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK. Ky dërgim i dytë ishte urdhëruar për të garantuar të drejtat procedurale të palës dhe për të neutralizuar rreziqet lidhur me ushtrimin e tyre. Ajo ishte kryer dhe vërtetuar në mënyrë të rregullt. Llogaritur nga data e këtij dërgimi të dytë - 22 shkurt 2013, periudha kohore 3-ditore e dhënë me Aktvendimin C.nr.2724/2006 e Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika I - III) në pajtim me nenin 102, paragrafi 1 LPK-së dhe neni 78, paragrafi 3 LPK ka kaluar më 25 shkurt 2013 përsëri pa largimin e të metave të padisë në bazë të nenit 390 LPK.

#### IV. ARSYET PËR HEDHJEN POSHTË TË PADISË SIPAS NENIT 391, PIKA G) LPK

14. Padia nuk përmban të gjitha kushtet e detyrueshme për përmbajtjen e saj në pajtim me nenin 253, paragrafi 1 dhe nenin 99, paragrafi, fjalia e parë dhe paragrafi 3 LPK. Mungesa e tyre e bën atë formalisht të mangët, të pakuptueshme për tu gjykuar nga gjykata në kundërshtim me kushtet e nenit 99, paragrafi 2, fjalia e dytë LPK, përveç nëse në mënyrë retroaktive rregullohet sipas nenit 102, paragrafi 2 LPK. Për këtë qëllim, paditësi me anë të Aktvendimit C.nr.2724/2006 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika I) u udhëzua për korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme të padisë dhe ishte përshkruar një periudhë prej tre (3) ditësh për t'i bërë ato në përputhje me nenin 102, paragrafi 1 LPK. Megjithatë, asnjë parashtresë nuk

ishte parashtruar në gjykatë për korrigjimin e padisë. Ky mos-korrigjim dhe mos-plotësim brenda afatit të caktuar ligjor sipas nenit 102, paragrafi 1, LPK barazohet me nenin 102, paragrafi 3, fjalia e parë, LPK me tërheqjen e padisë, që është arsyeja e parë për pushimin e procedurave në pajtim me nenin 387, paragrafi 1, pika w) LPK.

15. Padia në rast është pa vërtetim të bashkangjitur për taksat e paguara gjyqësore, në kundërshtim me nenin 253, paragrafi 4 LPK, Seksionin 3.1, Seksionin 4.4 dhe Seksionin 6.1 i Urdhëresës Administrative № KGJK 2008/2002. Prandaj, më anë të Aktvendimit C.nr.2724/2006 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika II) paditësit i është dhënë një njoftim sipas Seksionit 6.5 të Urdhëresës Administrative KGJK № 2008/2002 për të paguar taksat gjyqësore në shumën e përcaktuar me tarifa sipas Seksionit 10 të saj brenda afatit 3-ditor, të parashikuar nga neni 102, paragrafi 1 LPK. Mos pagesa e tyre, pa përjashtim, sipas neneve 468-469 LPK ose Seksioni 7.2 i Urdhëresës Administrative të KGJK № 2008/02 konsiderohet sipas nenit 253, paragrafi 5 si tërheqje e padisë dhe si një arsye për hedhjen poshtë të saj në pajtim me nenin 102, paragrafi 3, fjalia e parë LPK dhe Seksioni 6.6 i Urdhëresës Administrative KGJK № 2008/02, me pushimin të gjykimit në pajtim me nenin 387, paragrafi 1, pika w) LPK-së dhe Seksioni 6.6 i Urdhëresës Administrative KGJK № 2008/2002.

16. Për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike, kontesti për ligjshmërinë e vendimit të ndarjes mund të zgjidhet vetëm njëlloj në lidhje me bartësin e së drejtës së ndarjes që e ka lëshuar atë dhe titullarin e së drejtës së banimit që ishte themeluar nga ai, si bashkëndërgjyqës të konsoliduar nën neni 269, paragrafi 1 LPK. Në mënyrë të ngjashme, mosmarrëveshja lidhur me vlefshmërinë e kontratës së kontestuar të blerjes mbetet të vendoset në të njëjtën mënyrë në lidhje me palët që e kanë lidhur atë - shitësi dhe blerësi sipas kushteve të bashkëndërgjyqësisë së konsoliduar sipas nenit 269, paragrafi 1 LPK. Prandaj PS proceduralisht nuk ka legjitimitet pasiv për të qenë i vetmi i paditur në këtë rast. Kjo është arsyeja pse me anë të Aktvendimit C.nr.2724/06 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika III) paditësi ishte udhëzuar që brenda tri (3) ditësh ta zgjeronte padinë ndaj të gjithë këtyre të paditurve që duhet të marrin pjesë në rast sipas nenit 78, paragrafi 1 LPK dhe në pajtim me rregullat e bashkëndërgjyqësisë së konsoliduar sipas nenit 269 LPK. Pasi që kjo periudhë kohore sipas nenit 78, paragrafi 3 LPK ka skaduar, dhe se gabimet në legjitimitetin pasiv nuk janë përmirësuar, padia e ngritur kundër një personi fizik që nuk mund të jetë i padituri i vetëm në rast duhet të hidhet poshtë në bazë të nenit 78, paragrafi 4 *in fine* LKP - një arsye e tretë sipas nenit 387, paragrafi 1, pika w) LPK për pushimin procedurat e këtij rasti.

17. Duke e përmbledhur, mos rregullimi i padisë në bazë të nenit 390 LPK për shkak të mos-heqjes së mangësive të lartpërmendura, sipas nenit 78, paragrafi 1 dhe nenit 102, paragrafi 1 LPK nga paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata është e sanksionuar proceduralisht nga neni 391, pika g) LPK me hedhje poshtë.

**V. ARSYET PËR HEDHJEN POSHTË TË PADISË SIPAS NENIT 166.2 LPK**

18. Sipas nenit 166, paragrafi 2 LPK, gjykata është e detyruar që të ketë parasysh *ex officio* gjatë tërë procedurës nëse kërkesa është gjykuar tashmë, dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar nga një padi e zgjidhur tashmë me vendim të formës së prerë, ajo do të refuzohet si e papranueshme.

19. Për të përmbushur detyrën e saj sipas nenit 166, paragrafi 2 LPK, gjykata është e autorizuar nga neni 332 LPK që t'i merr *ex officio* të gjitha dokumentet e nevojshme nga ndonjë subjekt publik. Kështu, me anë të aktvendimit C.nr.2724/2006 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, datë 15 janar 2013 (pika V) Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) i është kërkuar që t'ia ofrojë gjykatës kopjet e dosjeve në DS000853 (A) dhe DS003414 (C) të Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore për banesën në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L-1, kati IX, nr.35. Dokumentet e kërkuara i janë dorëzuar rastit me anë të letrës ref.nr.00055/13/gz të Drejtorit të AKP-së, të datës 17 janar 2013. Pas shqyrtimit të tyre nga gjykata, është vërtetuar si më poshtë.

20. Më 15 nëntor 1999, hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/23 mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore (HPD) dhe Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore (HPCC). Seksioni i saj 1.2 parashikon se si një përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, HPD-ja do të marrë, regjistrojë dhe do t'i referojë HPCC-së për zgjidhjen e kërkesave të listuara në dispozitë, *inter alia*: a) Kërkesat e personave fizikë, të cilëve pronësia, posedimi ose e drejta e banimit me pronën e patundshme banesore iu ishin revokuar pas datës 23 mars 1989 në bazë të legjislacionit diskriminues në zbatimin apo qëllimin e tij; c) Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose bartës të së drejtës banesore në pronën banesore para 24 marsit 1999, nuk e gëzojnë posedimin e tij, ku prona nuk është transferuar vullnetarisht. Seksioni 2.5, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 më tej thotë se HPCC-ja ka juridiksion ekskluziv për të zgjidhur kategoritë e kërkesave të listuara në Seksionin 1.2.

21. Më 23 nëntor 2000, FK ia ka paraqitur HPD-s një kërkesë (Nr. DS000853) sipas Seksionit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK Nr. 1999/23 me pretendimet se banesa në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L- 1, kati 9, nr.35 i ishte ndarë atij, gjersa ishte në ndërtim e sipër në bazë të marrëdhënies së punës me Vendimin № 267/1989 të 16 shkurtit 1989 dhe Vendimin № 2092 të 18 shtatorit 1989 të Këshillit të Punëtorëve të OPPB "Elektroekonomia e Kosovës", OP PER PRODHIMIN E THENGJILLIT, OTHPB MS. "KOSOVA"-BELLAQEVCË, dhe Vendimit № 2093 të 18 shtatorit 1989 të Drejtorit të ndërmarrjes. FK ka konstatuar gjithashtu se me anë të Vendimit № 3432 të 16 nëntorit 1990 të ORGANIT TË PËRKOHSHËM të NP "ELEKTRO-EKONOMIA E KOSOVËS PER PRODHIMIN E THENGJILLIT DHE ENERGJISË ELEKTRIKE" marrëdhënia e tij e punës i ishte ndërprerë si masë diskriminuese. Ai e kundërshtoi largimin e tij nga puna me anë të kundërshtimit ref.nr.876, datë 23 janar 1991 para Organit të Përkohshëm, dhe më vonë përmes ankesës, së depozituar më 4

mars 1991 në Gjykatën e Punës së Bashkuar në Prishtinë që asnjëherë nuk kishte qenë vendosur. FK pranoi se ai nuk kishte lidhur kontratë për shfrytëzimin e banesës me Ndërmarrjen Publike për Banim dhe vetëm e kishte marrë në posedim në vitin 1999, pas fushatës ajrore të NATO-s. Kërkesa e FKT drejtuar HPD/HPCC-s ishte që t'ia kthenin të drejtën e tij pronësore mbi banesën.

22. Më 27 dhjetor 2001, PSI ia ka paraqitur HPD/HPCC-s një kërkesë (Nr. DS003414) sipas Seksionit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK Nr.1999/23 me pretendime faktike se atij i ishte ndarë banesa e kontestuar me anë të Vendimit № 2517 të Komisionit për Ankesa të punëdhënësit të tij, të datës 26 gusht 1992, kishte hyrë në të dhe kishte lidhur një kontratë për shfrytëzimin e saj, № 1193/15292, datë 10 shtator 1992 me Ndërmarrjen Publike për Banim të Prishtinës. Më vonë "ELEKTROPRIVREDA SRBIJE, JP ZA PROIZVODNJU, PRERADU I TRANSPORTI UGLJA - POVRŠINSKI KOPOVI "KOSOVA", si shitës dhe PSI si blerës kanë lidhur një kontratë për blerjen e saj № 3582/1920, të datës 2 mars 1993, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, Vr.nr.9182/93 më 29 shtator 1993. Në fund, PSI pohoi para HPD/HPCC-s që ai kishte ikur nga Kosova më 22 qershor 1999 për shkak të rrethanave të konfliktit, e humbi posedimin e banesës dhe kërkoi ri-posedimin e saj.

23. Procedurat e HPD/HPCC-s lidhur me kërkesat e mësipërme, të dyja të paraqitura brenda afatit ligjor sipas Seksionit 3.2, fjalia e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 - 1 korrik 2003, pasi që konkurrohej për një dhe për të njëjtën banesë, duke ngritur çështje të përbashkëta ligjore dhe dëshmuese, u bashkuan në përputhje me Seksionin 19.5 (a) të Rregullores së UNMIK Nr. 1999/23. Ato ishin zgjidhur nga HPCC-ja në shkallë të parë me anë të Vendimit nr. HPCC/D/97/2003/A dhe C, datë 17 tetor 2003. Kërkesa A DS000853 e FKT u refuzua për shkak se ai nuk arriti të dëshmojë ndonjë të drejtë pronësore që do të mundësonte kthimin e saj, siç kërkohet nga Seksioni 1.2 (a) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, duke mos qenë në gjendje për të treguar se ai ndonjëherë kishte pasur një posedim të ligjshëm mbi banesën (paragrafi 7). Kërkesa C DS003414 e PSIT u aprovua nga HPCC-ja, pasi që ai kishte dëshmuar pronësinë *prima facie* mbi banesën, humbjen e posedimit të saj në rrethanat e fushatës ajrore të NATO-s dhe nuk ka disponuar vullnetarisht me të drejtën e tij (paragrafët 11 dhe 13). Prandaj, HPCC-ja vendosi në favor të paditësit C duke urdhëruar rikthimin e tij në posedimin e banesës, duke e obliguar cilindo person që e posedon atë që ta lirojë atë brenda 30 ditësh nën kërcënimin e dëbimit, në rast se nuk e përmbushë këtë obligim brenda kohës së caktuar.

24. Më 23 nëntor 2004, FK ia dorëzoi HPD-s një kërkesë në Komisionin për rishqyrtimin e vendimit të saj nr. HPCC/D/97/2003/A dhe C, datë 17 tetor 2003 në pajtim me Seksionin 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000/60. Ajo iu miratua pjesërisht me Vendimin nr. HPCC/REC/60/2006, datë 31 mars 2006, ku Vendimi Nr. HPCC/D/97/2003/A dhe C, datë 17 tetor 2003 u anulua dhe u ndryshua *sa i përket*



*Kërkesës A DS000853 me:* a) refuzimin e saj, b) referimin në gjykatën lokale për përcaktimin e kompenzimit ligjor, nëse ka, në dispozicion të paditësit A, sipas ligjit në fuqi për mënyrën që pretendohet si e parregullt, në të cilën ishte ndarë banesa dhe ishte fituar nga paditësi C; c) ngrirja e urdhrin për të ndaluar të gjitha bartjet deri në vendimin e gjykatës vendore, përveç në bazë të një zgjidhjeje miqësore midis palëve që do të përfundojë nëse paditësi A brenda 60 ditësh e dorëzon në gjykatë një njoftim për të vazhduar procedurën. Në rishqyrtim kërkesa C DS003414 e PSIT iu miratua përsëri-me Vendimin Nr. HPCC/REC/60/2006, datë 31 mars 2006 (pika 2) ishte urdhëruar rikthimi i tij në posedim të banesës, duke e obliguar cilindo person që e kishte uzurpuar atë që ta lirojë atë brenda 30 ditësh nën kërcënimin e dëbimit. Në rishqyrtim, Komisioni ri-konfirmoi konkluzionet e saj të shkallës së parë që FK si Kërkuesi A nuk kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme për të drejtat e pronësisë mbi banesën, dhe asnjëherë nuk kishte hyrë në zotërim të saj të ligjshëm, siç kërkohet për ekzistencën e një të drejte të zënies së vlefshme (paragrafi 5). Sipas kërkesës së lidhur C DS003414 në rishqyrtim HPCC përsëriti gjetjet e saj në shkallë të parë, që PSI kishte treguar *prima facie* të drejtat pronësore mbi banesën, humbjen e posedimit të saj në rrethanat e fushatës ajrore të NATO-s, si dhe mos-disponimin me pronësinë, në pajtim me Seksionin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Seksionin 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 (paragrafi 9). Në këtë drejtim HPCC-ja e verifikoi si të vërtetë kontratën për shfrytëzim të datës 10 shtator 1992 dhe kontratën e blerjes së 29 shtatorit 1993, të paraqitura nga PSI në mbështetje të pretendimit të tij, dhe kështu vendosi se ai kishte fituar një të drejtë *banimi* bazuar në kontratën e parë dhe pastaj një të drejtë *pronësie* - bazuar në të dytin. Kështu, kërkesa C DS003414 më në fund u miratua nga HPCC-ja si e provuar me dëshmi të mjaftueshme në pajtim me fitimin e pronësisë mbi banesën nga PSI para 24 marsit 1999 dhe përputhshmërinë me kushtet e tjera të përcaktuara në Seksionin 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Seksionin 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60.

**25.** Vendimi i HPCC-s Nr. HPCC/REC/60/2006, datë 31 mars 2006 u nënshkrua nga Kryetari në bazë të Seksionit 22.9, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. *Përfundimi* i këtij vendimi si datë e lëshimit të saj ishte verifikuar në mënyrë eksplicite në faqen e tij të fundit në lidhje me dhe citimin e dispozitës së Seksionit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23.

**26.** *Vendimi individual* i HPCC-s për rishqyrtim me palën kërkuese FK dhe palën e paditur PSI në kërkesat DS000853 dhe DS003414 për banesën në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L-1, kati IX, nr.35 në bazë të Vendimit të Përbashkët HPCC-së Nr. HPCC/REC/60/2006, datë 31 mars 2006, ishte vërtetuar nga regjistruesi i HPCC-së më 11 maj 2006, si parashikohet nga Seksioni 22.9, fjalia e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Pas citimit të pjesës përkatëse të dispozitivit të Vendimit të Përbashkët nr. HPCC/REC/60/2006, u theksua se kërkesat DS000853 dhe DS003414 pasi ishin hulumtuar dhe gjykuar u zgjodhën si pjesë e këtij Vendimi të Përbashkët sipas Seksionit 22.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, duke i miratuar të

gjitha vendimet individuale të identifikuara në të, ku përveç paragrafëve të zbatueshëm në përgjithësi të arsytimit të saj, zbatohen në mënyrë specifike paragrafët 2, 4, 5, 7, 8 dhe 9 për pretendimet DS000853& dhe DS003414.

**27.** Kopje të vërtetuara të Vendimit të Rishqyrtimit të HPCC-së të mësipërm iu ishin dorëzuar nga HPD-ja, në përputhje me Seksionin 13.1, fjalìa e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, FKT më 26 maj 2006, dhe PSIT më 31 maj 2006 të evidentuara nga fletëdërgesat e nënshkruara. Kështu Vendimi Nr. HPCC HPCC/REC/60/2006 ka hyrë në fuqi nga data e dorëzimit të saj palës së fundit-31 maj 2006, pasi nuk parashikohet ndryshe në bazë të Seksionit 13.1, fjalìa e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Nuk ishte zbatuar asnjë mjet tjetër juridik *de facto* ose *de jure* kundër saj nga palët dhe/ose personat e tretë.

**28.** Vendimi nr.HPCC/REC/60/2006, datë 31 mars 2006 u bë i ekzekutueshëm 30 ditë pas dorëzimit të saj paditësit FKT më 26 maj 2006, si banues i banesës në atë kohë – Seksioni 13.3 i Rregullores së UNMIK Nr. 2000/60. Urdhri për dëbim 2006/W/4602/HPCC i lëshuar nga regjistruesi më 4 korrik 2006 u ekzekutua nga HPD-ja ashtu siç parashihet me Seksionin 13.3, pika a) dhe Seksionin 13.6, fjalìa e parë dhe e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 më 14 korrik 2006. Çelësat e banesës iu dorëzuan një përfaqësuesi të PSIT më 19 korrik 2006, e verifikuar nga një protokoll - vërtetim i pranimit-dorëzimit të çelësave, me ç ‘rast, më 25 korrik 2006, prona e kërkuar u regjistrua si e pranuar (e marrur) në ri-posedim nga ky kërkuar C, dhe më 8 gusht 2006, rasti i HPD/HPCC-s u mbyll.

**29.** Procedura e rishqyrtimit sipas Seksionit 14 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, ishte përfunduar me Vendimin e HPCC-s Nr. HPCC/REC/60/2006 31 mars 2006 siç është paraparë me Seksionin 25 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në mungesë të ndonjë mjeti tjetër juridik të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/60 dhe jo-zbatueshmërisë së atyre sipas ligjit të përgjithshëm procedural (LPK) sipas Seksionit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Seksionit 28 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, Vendimi HPCC Nr. HPCC/REC/60/2006 mori formën e prerë nga data e lëshimit të saj sipas kushteve të Seksionit 22.9, fjalìa e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 - 31 mars 2006, e certifikuar zyrtarisht nga regjistruesi HPCC në përputhje me Seksionin 22.9, fjalìa e dytë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 më 11 maj 2006. Kështu, procedurat e HPD/HPCC-s mbi kërkesat pronësore juridike DS000853 &DS003414 të paraqitura nga FK dhe PSA bazuar në Seksionin 1.2 (a) dhe (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23 lidhur me banesën e kontestuar në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L-1, kati 9, nr.35 kishte përfunduar me shterimin e mjeteve juridike në dispozicion nën Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/60. Rrjedhimisht, vendimi i HPCC-s Nr. HPCC/REC/60/2006 u bë i formës së prerë, ekzekutiv dhe i detyrueshëm, nuk i nënshtrohej rishikimit nga ndonjë gjykatë ose autoritet administrativ në Kosovë, në pajtim me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23.

**30.** Baza ligjore e vendimit të HPCC-s Nr. HPCC/REC/60/2006 është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, e cila mbizotëron mbi ligjet e tjera të aplikueshme mbi të drejtat e pronës – Seksioni 4 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, dhe shfuqizon të gjitha dispozitat në kundërshtim me to – Seksioni 28 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Fjalja e parë e Seksionit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, të cituar më sipër, e autorizoi HPD-n për të pranuar dhe regjistruar kërkesat e listuara në dispozitë, *duke kufizuar kompetencat e gjykatave vendore* në këtë drejtim. HPCC-ja është themeluar me Seksionin 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 si një organ i pavarur i HPD-s, për t'i zgjidhur kontestet private jo-komerciale për pronën e banimit, të cilat i referohen asaj nga HPD-ja deri sa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konstaton se gjykatat lokale janë në gjendje për të kryer funksionet e tilla. Prandaj, HPCC-ja duhet të njihet si një gjykatë në kuptim të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (ECHR), duke i pasur karakteristikat kryesore të përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (*Bellios v Zvicër* A 132 (1988), 10 EHRR 466; *Qipro v Turqi* 2001-IV, 35 EHRR 731; *H. v Belgjikë*, A 127-B (1987) 10 EHRR 339). HPCC-ja është themeluar në bazë dhe në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë. Ai ishte ngarkuar me *funksione gjyqësore*, të marra përkohësisht nga gjykatat vendore deri kur iu transferuan përsëri atyre pas përfundimit të mandatit të tij. HPCC-ja i ka përmbushur kushtet për pavarësi – Seksioni 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, paanësi - Seksioni 17.12 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, kushtet e anëtarëve të zyrës – Seksioni 17.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, dhe garancitë e ofruara nga procedurat e saj-Seksioneve 18 dhe 19 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Më e rëndësishmja, HPCC-ja kishte fuqinë ligjore *për të zgjidhur mosmarrëveshjet private* në pronat e banimit me anë të *vendimit ligjërisht të ekzekutueshëm* në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në një mënyrë të parashkruar (*Bentham v Holandë* A97 (1985) 8 EHRR 1 PC). Kjo ishte një çështje gjyqësore substanciale në kontestet gjyqësore që mund të zgjidhen vetëm përmes zgjidhjes gjyqësore. Vendimet e HPCC-s nuk mund të vihen mënjanë nga ndonjë organ administrativ (*Cooper v UK* 2003-XII 39 EHRR 171GC), ndërsa zbatimi i tyre nuk mund të pezullohet nga një institucion tjetër publik në bazë të ligjit (*Van de Hurk v Holanda* A 288 (1994) 18 EHRR 48, paragrafi 45). Prandaj, vendimet e HPCC-së, duke qenë të lëshuara nga juridiksioni pas përfundimit të tyre u bënë *res judicata* lidhur me kontestet pronësore të zgjidhura dhe nuk mund të kontestohen apo të shpërfillen, të kundërshtohen apo të rivendosen, duke pasur të njëjtën vlerë ligjore si aktet e gjykatave të rregullta.

**31.** Mbi këtë bazë ligjore, HPCC-ja e ka gjetur të pranueshme kërkesën DS000853 të ngritur nga FK më 23 nëntor 2000 sipas Seksionit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, dhe kërkesën DS003414 të paraqitur nga PSI më 27 dhjetor 2001 sipas Seksionit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, *inter alia*, pasi

që bie brenda kompetencave të saj sipas Seksionit 2.5, fjalia e parë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Bazuar në nenin 19.5 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 këto dy kërkesa janë vendosur së bashku nga HPCC-ja në shkallë të parë dhe të dytë me shterjen e rishqyrtimit të paraparë me Seksionin 14 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 dhe jo-zbatueshmërinë e mjeteve juridike - të rregullta dhe të jashtëzakonshme, sipas ligjit të përgjithshëm për procedurat civile. Siç është cekur më lart, me vendimin e saj përfundimtar Nr.HPCC/REC/60/2006 ka refuzuar kërkesën e FKT pasi që ai dështoi që të ofrojë dëshmi për ndonjë të drejtë pronësore prej atyre të listuara në Seksionin 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 (*pronësia, posedimi i ligjshëm, e drejta për shfrytëzim ose e drejta e banimit*), që mundëson rikthimin në përputhje me Seksionin 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Seksionin 2.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në të njëjtën kohë, HPCC-ja e aprovoi kërkesën e PSIT si të plotësuar Seksioni 1.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23 dhe Seksionin 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, *inter alia*, i vërtetoi të drejtat pronësore sipas Seksionit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 – së pari një të drejtë banimi e dëshmuar me kontratën për shfrytëzim të 10 shtatorit 1992, dhe pastaj një të drejtë pronësie e fituar nga kontrata e blerjes së 29 shtatorit 1993, të dyja të vërtetuara në procedura të HPCC-s si të vërteta. HPCC-ja vendosi të drejtat pronësore në DS000853 dhe DS003414, duke urdhëruar ri-posedimin e banesës në favor të PSIT - Seksioni 22.7 (b) i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000/60, dhe duke refuzuar kërkesën A të FKT - Seksioni 22.7 (f) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në të gjitha elementet e tij dispozitivi i këtij HPCC vendimi është *përcaktues* për këto të drejta kontestimore civile në kuptim të nenit 6 (1) të KEDNJ.

**32.** Banesa e kontestuar ashtu siç është e përfshirë nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/23 që nga hyrja e tij në fuqi më 15 nëntor 1999, me Seksionin 2.5 të saj ishte marrë nga kompetencat e gjykatave lokale dhe ishte vendosur nën juridiksionin ekskluziv të HPCC-s për t'i zgjidhur pretendimet lidhur me këtë pronë banesore të listuar në Seksionin 1.2 si ato të FKT dhe PSIT. Ato ishin zgjidhur me anë të Vendimit të HPCC-s Nr.HPCC/REC/60/2006, i cili në pajtim me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23, duke qenë i formës së prerë që nga data e lëshimit të saj - 31 mars 2006 u bë i detyrueshëm (*res judicata*), dhe i detyrueshëm sipas Seksionit 13 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, nuk i nënshtrohet rishikimit nga ndonjë gjykatë ose autoritet administrativ në Kosovë. Këto efekte ligjore të parapara normativisht me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 janë të njohura në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, duke deklaruar qartë se vendimet përfundimtare të HPCC-s janë *res judicata*, lidhur me të drejtën e pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-s, gjersa çdo ndërhyrje në gëzimin e saj të qetë nga një gjykatë përmes rigjykimit të të njëjtit kontesti, të zgjidhur më parë nga HPCC-ja, duhet të konsiderohet si një shkelje

e kësaj të drejte të njeriut (aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr.KI.104/10, *Arsic Draža vs Karacevo*, të 23 prillit 2012, paragrafët 64, 73, 75, 76 dhe 79).

33. Gjithashtu, praktika e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) është që të hidhen poshtë ankesat e paraqitura në të, të shqyrtuara më parë dhe të vendosura me vendime të formës së prerë të HPCC-s për shkak të *res judicata* së tyre në pajtim me Seksionin 11.4 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, miratuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dhe Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23 (Vendimi Nr.KPCC/D/R/152/2012 i KKPK-së 19 prill 2012, paragrafët 41-45). Pa dispozitat kalimtare të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/10, Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, Urdhërësës Administrative Nr. 2007/5, dhe Ligjit Nr. 03/L-079, të cilat parashohin ndryshe, të gjitha vendimet e marra nga HPCC-ja, pas themelimit të AKP-së dhe KPCC-së vazhdojnë të jenë ligjërish të vlefshme.

34. *Res judicata* e krijuar nga çdo vendim përfundimtar i HPCC-së, pavarësisht nga lloji i kërkesës (kërkesave) të mbuluara dhe/ose rezultati, në funksionin e tij negativ ndalon çdo gjykatë, nëse ndalohet me këtë kontest, për të gjykuar dhe për të vendosur sipas meritave (*non bis in idem*). Kjo mos-zgjedhshmëri e kontestit të zgjidhur duke qenë një *parakusht absolut negativ procedural* bën çfarëdo kërkesë të mëvonshme të papranueshme, pasi që e drejta procedurale për paraqitjen e saj është përjashtuar nga *res judicata* e vendimit përfundimtar të HPCC-së. Seksioni 2.7 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 ndalon shqyrtimin e saj, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga ndonjë gjykatë e Kosovës duke garantuar pathyeshmërinë e saj në përputhje me parimin e sigurisë juridike. *Res judicata* e saj pengon paraqitjen e një kërkesë të re si ajo e vendosur nga HPCC-ja, e bën të palejueshme çfarëdo gjykimi tjetër në mes të palëve të njëjta me të njëjtën temë, dhe lejon që vendimi final i plotfuqishëm i HPCC-s të mbetet në fuqi, duke iu shmangur dualizmit me vendimin (vendimet) kontradiktore. *Res judicata* pengon çfarëdo rivendosje të mosmarrëveshjes nga ana e institucionit të procedurave gjyqësore në atë, pasi që neni 166, paragrafi 2 dhe neni 391, pika d) LPK domosdoshmërisht detyron gjykatën që sipas detyrës zyrtare të hedh poshtë kërkesën që e dyfishon atë që është vendosur përfundimisht nga ana e HPCC-s në pajtim me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 bazuar në kompetencat e saja ekskluzive sipas Seksionit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23.

35. FK dhe PS duke qenë palë në procedurat e HPD-HPCC-së dhe të adresuarit e Vendimit Nr.HPCC/REC/60/2006 të datës 31 Mars 2006, ishin të detyruar që ta ndërpresin mosmarrëveshjen e tyre në lidhje me banesën në Prishtinë, “Dardania” SU-9, L-1, kati I 9-të, Nr.35. Pasi që ky vendim ka hyrë në fuqi me datë 31 Mars 2006, ata nuk kanë mundur që t’i kundërshtojnë përcaktimet faktike dhe ligjore të përfshira në të, sa i përket kësaj prone banesore, e cila e bën statusin e saj të gjykuar, të definuar, përtej mosmarrëveshjes. Për shkak të bashkimit të DS000853 & DS0003414, me Vendimin Nr. HPCC/REC/60/2006, HPCC e refuzoi, në pajtim me

Paragrafin 227.7 (f) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60, kërkesën sipas Seksionit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 duke *mohuar* të drejtat pronësore të FKT mbi banesën, dhe njëkohësisht ka miratuar kërkesën, sipas Seksionit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23 duke *konfirmuar* pronësinë e PSIT mbi të dhe duke urdhëruar ri-posedimin në favor të tij në bazë të Seksionit 22.7 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000/60. Ky i fundit është rikthyer në posedimin e humbur të kësaj prone banesore si *pronari* i saj në hipotezën e parë të Seksionit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23, e legjitimuar nga kontrata e blerjes e datës 29 Shtator 1993, dhe *anasjelltas* jo si *ish-posedues* në hipotezën e dytë të Seksionit 1.2 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 në lidhshmëri me Seksionin 22.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Të gjitha shkaqet në dispozicion të palëve janë ekzaminuar në procedurat e HPCC-së dhe janë shfrytëzuar deri në fund në kornizën e saj. Të drejtat pronësore mbi këtë banesë, mbi bazat faktike dhe ligjore të deklaruara para HPCC-s ishin konstatuar mbi meritat e saja me HPCC Vendimin Nr. HPCC/REC/60/2006 dhe duke qenë *res judicata* që nga data 31 Mars 2006, nuk ka mundur që të kontestohet më pas, të gjykohet apo ndryshe të shfuqizohet.

**36.** Duke u bazuar në Seksionin 2.5, fjalia e parë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Seksionin 22.7 (g) me pikën 1(b) të Vendimit Nr. HPPCC/REC/60/2006, i është dhënë gjykatës kompetente vendore *vetëm* për të përcaktuar në një procedurë të rregullt, nëse do të ishte iniciuar fare brenda 60 ditësh pas kësaj, kompensimi ligjor në dispozicion sipas ligjit në fuqi për këtë parashtrues A të kërkesës për mënyrën e parregullt të supozuar, me të cilën banesa në fjalë ishte ndarë dhe pastaj fituar nga ky paditës C. Kështu, çështja e vetme e referuar nga HPCC-ja tek kjo gjykatë e shkallës së parë ka qenë vetëm diskriminimi dhe mbi ekzistencën e tij, shpërblimi si një kompensim alternative ligjor kundër bartësit të së drejtës së ndarjes, një kompensim monetar për dëmet diskriminuese të cilat kanë mundur të shkaktohen nga kjo ndërmarrje si punëdhënës i FKT pas datës 23 Mars 1989. Sidoqoftë, rikthimi aktual në gjykatë në këtë rast, nuk i përgjigjet referencave të parashikuara nga HPCC-ja.

**37.** Palët në procedurat e përfunduara të HPCC-së, duke qenë të obliguar nga Vendimi Nr.HPCC/REC/60/2006 sipas Seksionit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 duhej që të përputhshin me të-PS kishte të drejtë të ushtrojë të drejtën e pronësisë mbi banesën, ndërsa FK, ishte i obliguar që të mos e shkel këtë të drejtë, apo që ta kontestojë më tej. Ky i fundit në kontrast, ka parashtruar një padi në gjykatë duke ri-argumentuar pronën e banesës në Prishtinë, “Dardania” SU-9, L-1, kati i 9-të, nr.35 me parë e zgjidhur nga HPCC. Nuk ka fakte të supozuara nga FK në C.nr.2724/2006 sapo të ndodhura pas datës 31 Mars 2006- data e plotfuqishmërisë së Vendimit të HPCC-së Nr. HPCC/REC/60/2006 si afat *i res judicat*-ës së saj. Të gjitha faktet në padinë e tij parashtruar në gjykatë me datë 20 Dhjetor 2006, të proceduara me 31 Mars 2006, kanë qenë të kërkuara tashmë para HPCC-së dhe janë përjashtuar nga *res judicata* e vendimit të saj. Të drejtat pronësore të vërtetuara nga Komisioni me datë 31 Mars 2006 nuk kanë mundur që të kundërshtohen më pas me faktet para

këtij momenti. Padia e parashtruar nga FK kundër PSIT mbi bazat e fakteve të tilla të vjetra rikthen mosmarrëveshjen e zgjidhur nga HPCC-ja- një mundësi e ndaluar me Vendimin Nr. HPCC/REC/60/2006. Kjo pengesë është e aplikueshme duke pasur parasysh *identitetin e fushës objektive të res judicata-ës së saj* dhe padisë në gjykatë, dhe identitetin e tyre subjektiv – FK dhe PS, të cilët pas të qenit palë në procedurat e HPCC-së janë aktualisht si palë ndërgjygjëse në rastin C.nr.2724/2006. Në përgjithësi, kufijtë personal, material dhe kalimtar të kërkesave konkurruese të zgjidhura nga HPCC-ja dhe *res judicata* e vendimit të saj përfundimtar, përputhen me ato të padisë së tanishme në gjykatë. Kjo përputhshmëri e plotë është rekuizitë për nenin 166, paragrafi 2 i LPK-së për tu aplikuar.

**38.** Meqë HPCC-ja përfundimisht ka përcaktuar çështjet e pronësisë në lidhje me banesën në Prishtinë, "Dardania" SU-9, L-1, kati 9-të, nr.35 në mes të FKT dhe PSIT, padia C.nr.2724/2006, si një përpjekje për të ringjallur këtë kontest pronësor, përfundimisht e zgjidhur nga ky juridiksion ekskluziv, duhet që të hidhet poshtë nga kjo gjykatë si *res judicata* në bazë të nenit 166, paragrafi 2 dhe Seksionit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. Ky gjyq i dyfishtë, i krijuar pas përfundimit të rastit të HPCC-së midis palëve të njëjta dhe në lidhje me lëndën e njëjtë, si çështje ligjërishit e ndaluar, duhet që të pushim sipas nenit 387, paragrafi 1, pika w) LPK. Padia e parashtruar në gjykatë për ri-zgjidhjen e një kontesti të vendosur është e palejueshme, meqë e drejta procedurale për dorëzimin e saj ishte përjashtuar nga *res judicata* e Vendimit përfundimtar i HPCC-së Nr. HPCC/REC/60/2006. Kjo e fundit duke qenë përcaktuese për të drejtat e pronës në fjalë, dhe bazat e tyre themelore ligjore, mund të pranohet vetëm nga Gjykata, gjersa gjykimi i rastit C.nr.2724/06 mund vetëm të shkaktojë shkelje procedurale thelbësore - shkelje e kompetencave të Gjykatës Themelore Prishtinë - neni 182, paragrafi 2, pika b) LPK dhe ri-vendosja e një padie *res judicata* të vendosur tashmë - neni 182, paragrafi 2, pika 1) LPK. Përpos kësaj, çdo ndjekje e këtij rasti nga gjykata do të ndërhyjë në të drejtën e pronës, të përcaktuar nga Vendimi përfundimtar i HPCC-së Nr. HPCC/REC/60/2006, e mbrojtur nga neni 46 i Kushtetutës dhe Neni 1 i Protokollit 1 të GJEDN-së, në shkeljen e ligjit të saj ndërkombëtar për garantim (aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr.KI.104/2010, *Arsic Draza kundër Karacevo* e datës 23 Prill 2012). Mos-ndërprerja e kontestimit të ri sipas nenit 166, paragrafi 2 i LPK-së po ashtu do ta dëmtojë të drejtën për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe neni 6(1) i GJEDN-së ( *Brumarescu kundër Romanisë App.* Nr. 28342/95, 1999-VII; 33 EHRR 862, paragraf 61) e cila *inter alia* kërkon se në përputhje me principin e sigurisë ligjore vendimi përfundimtar i *res judicata-s* mbi të drejtat civile nuk vihen në pyetje në mënyrë që të ngelen të pakthyeshme sa i përket stabilitetit të efekteve të tyre ligjore dhe andaj ta ruajë të paprekshme të drejtën pronësore, pasojat tanimë të shkaktuara nga zbatimi i tyre.

**VI. PËRFUNDIM**

39. Bazuar në arsyet e përmendura më lart, gjykata konstaton se padia në këtë rast nuk i përmbush kërkesat e nevojshme për pranueshmërinë e tij siç parashtrohen me ligjin e aplikueshëm dhe e hedhë poshtë atë për mos-korrigjim dhe mos-plotësim të përmbajtjes së saj, në pajtim me nenin 391, pika g) në lidhje me nenin 102, paragrafi 3, fjalia e parë LPK, mos-rregullimin e fushës së tij subjektive në pajtim me nenin 78, paragrafi 4 në LPP *in fine*, mos-pagesën e taksave gjyqësore, në pajtim me nenin 253, paragrafi 5 LPK në lidhje me Seksionin 6.6 të Urdhëresës Administrativ № 2008/02 i KGJK-së, dhe si *res judicata* në pajtim me nenin 166, paragrafi 2 dhe nenin 391, pika d) LPK në lidhje me Seksionin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23.

Në bazë të arsytimit të lartpërmendur është vendosur si në dispozitiv.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Sipas nenit 206, paragrafi 1 LPK secila palë mund të paraqesë ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së tij.

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**

**C.nr.2724/2006 më 26.02.2013**

---

**GJYKATËSJA E EULEX-IT ROSITZA BUZOVA**

*Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 Mbi Kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*

**PËRKTHYER NGA ANGLISHTJA NË SHQIP NGA:  
MESERE KOVAQI, PËRKTHYESE NË EULEX**